



Erasmus+

**Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Anëtarësime në Universitetin Publik
"Kadri Zeka", Gjiilan,**

shpall këtë:

**Thirrje për aplikime për shkëmbim studentor/semestral
në Universitetin "University of Applied Sciences" në
Nysa", Poloni**

Universiteti Publik "Kadri Zeka", është pjesë e projektit KA171 ICM, 2026, Erasmus+ dhe numër të projektit: 2026-1-PL01-KA171-HED-000441633, në partneritet me Universitetin e University of Applied Sciences në Nysa, Poloni.

Programi Erasmus + KA171 ose shkëmbimi afatshkurtër dhe afatgjatë i studentëve (ICM) është një program i mobilitetit **plotësisht i financuar nga projekti** që mundëson shkëmbimin e studentëve, stafit mësimdhënës dhe jo-mësimdhënës midis Universitetit të University of Applied Sciences nga Polonia dhe Universitetit Publik "Kadri Zeka", Gjiilan.

ICM Erasmus + mundëson shkëmbimin e studentëve nga Universiteti "Kadri Zeka" – Gjiilan për studim dhe trajnim / veprimtari të lëvizjes në fusha të ndryshme, në këtë thirrje studentëve u mundësohet që një semestër ta përfundojnë në Universitetin e University of Applied Sciences në qytetin e Nysa në Poloni.

Mundësi aplikimi kanë studentët nga Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe Fakulteti Ekonomik. Për studentët e këtyre fakulteteve vlenë thirrja për nivelin **Bachelor** si dhe për nivelin **Master**.

Në këtë thirrje do të pranohet një(1) studentë. Mobiliteti semestral duhet të realizohet gjatë semestrit veror, viti akademik 2026-2027, (Mobiliteti zgjat 5 muaj apo një semestër i plotë).



Të gjitha shpenzimet janë të mbuluar nga projekti në Universitetin pritës.

Pra:

- 📅 **Semestri:** Veror / Spring Semester
- 📅 **Viti akademik:** 2026/2027
- 🕒 **Kohëzgjatja:** 5 muaj
- 👤 **Studentë:** 1 student nga UKZ
- 💰 **Individual support:** deri në €4,000, bazuar në ditët reale të mobilitetit
- ✈️ **Travel support:** €309
- 💵 **Totali:** deri në €4,309
- 📍 **Destinacioni:** University of Applied Sciences in Nysa (PANS Nysa), Poloni
- ⭐ Përfshihet edhe **International Summer Programme 2027**, më 28 qershor – 9 korrik 2027.

Shënim:

- 1) Të gjithë pjesëmarrësit duhet t'i përmbahen kufizimeve të alokuara buxhetore pasi që nuk ka fonde shtesë.
- 2) Buxheti i udhëtimit llogaritet sipas llogaritësit të udhëtimit dhe edhe nëse tarifa e biletës tejkalon shumë e mbështetjes së udhëtimit, nuk mund të jepen fonde shtesë për pjesëmarrësit.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Certifikata e notave;
- CV (në gjuhën angleze);
- Një letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim studenti (i lëshuar nga fakulteti juaj që konfirmon nivelin tuaj dhe vitin e studimit gjatë këtij viti akademik, jo më të vjetër se 30 ditë);
- Kopje e pasaportës (faqja që përmban emrin tuaj, fotografinë dhe të dhënat personale) ose Letërnjoftimit;

Programet e ofruara në këtë mobilitet do të ofrohen në gjuhën angleze dhe si rrjedhojë kërkohet njohja e gjuhës angleze.

1. Studenti duhet të ketë të përfunduar të paktën 1 semestër në programin në të cilin janë regjistruar. Deri në ditën e fundit për aplikim, studentët të cilët kanë notë mesatare mbi 8.00 llogaritet si përparësi në aplikim.
- 2). Që studentët të marrin një grant të ICM-se, ata duhet të kalojnë të paktën një semestër (3 muaj) në universitetin pritës. Granti i mobilitetit të studenteve të ICM mbulon minimumi 90 ditë.
- 3). Studentët që do të marrin pjesë në programet e mobilitetit janë të obliguar të përfundojnë lëndë nga universiteti pritës në vlerën e ECTS-ve të kërkuara (rreth 5 kurse apo 28/30 ECTS).



Vlerësimi i aplikantëve:

- Mesatarja e notës: 50%
- Gjuhë e huaj: 50%

PROCEDURA E APLIKIMIT

- Aplikimet duhet të dorëzohen në Zyrën për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Anëtarësime (kopje fizike) ose online betim.berisha@uni-gjilan.net, në mes të datave 25.09.2026 deri 25.10.2026.

Aplikimet e vonuara nuk do të pranohen.

- Rezultatet e aplikimit do të shpallen në www.uni-gjilan.net

Për çdo informatë shtesë, kontaktoni zyrën për bashkëpunim ndërkombëtar në UKZ.

Me respekt,

Betim Berisha
Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Anëtarësime